



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI NË UNIVERSITETIN TEKNIK TË STAMBOLLIT (UTS) TURQI,
VITI AKADEMIK 2023-2024**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) të Republikës së Shqipërisë me Universitetin Teknik të Stambollit (UTS) të Republikës së Turqisë, si edhe Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes palëve të sipërcituara, MAS publikon thirrjen për përfitimin e të drejtës së studimit (ku përfshihet tarifa e shkollimit dhe pagesa e konviktit) për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pranë Universitetit Teknik të Stambollit, në ciklin e studimit Bachelor, për vitin akademik 2023-2024, në fushat e studimit që ofron UTS.

Mund të aplikojnë të gjithë nxënësit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme dhe që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në thirrjen e shpallur nga UTS për të ndjekur studimet universitare në Universitetin Teknik të Stambollit (ITU) për vitin akademik 2023-2024.

Kandidatët duhet të bëjnë aplikimin online në faqen zyrtare të Universitetit Teknik të Stambollit, **deri më 18 gusht 2023**. Për më shumë informacion rreth dokumentacionit që duhet ngarkuar në aplikim, procedurën e përzgjedhjes, programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Teknik i Stambollit në Turqi mund t'i gjeni në faqet e internetit:

https://www.sis.itu.edu.tr/duyuru_ekler/yabanci/202310/EN/index.php